



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Ambasada e Hungarisë ka njoftuar hapjen e thirrjes për aplikime për Bursat Shtetërore Hungareze për kurse verore në Hungari, për verën e vitit 2026.

Aplikimet mund të paraqiten nga shtetas të vendeve/territoreve partnere, sipas marrëdhënieve dypalëshe dhe kushteve specifike të përcaktuara në thirrjet për aplikim. Pjesëmarrja varet nga kriteret e secilës thirrje përkatëse.

Gjuha e dokumenteve mund të jetë hungarisht, anglisht, ose gjuha që do të zhvillohet kursi veror. Nëse dokumentet nuk janë shkruar në njërën nga këto gjuhë, duhet të bashkëngjiten edhe përkthimet zyrtare në gjuhën hungareze ose angleze.

Dokumentet që duhen për aplikim janë:

- Formulari i aplikimit;
- Letra e motivimit;
- Dëshmia e njohurive të gjuhës (hungarisht, anglisht ose gjuha e kursit të zgjedhur);
- Diploma me listën e notave dhe përkthimet e saj në hungarisht ose anglisht, ose në gjuhën e kursit të zgjedhur;
- Letër rekomandimi;
- Kopje e dokumentit të identifikimit;
- Pranimi i Deklaratës për Aplikim dhe Deklarata e Privatësisë.

Dokumenti i thirrjes, kushtet e aplikimit dhe lista e dokumenteve të nevojshme janë të disponueshme në faqen zyrtare: <http://tka.hu/international-programmes/4133/information-for-applicants>

Afati i fundit për aplikim është data 27 shkurt 2026, ora 17:00 (Ora e Evropës Qendrore) dhe aplikimet pranohen vetëm online përmes platformës zyrtare: <https://apply.diasporascholarship.hu>

Lista e kurseve verore së bashku me programin e studimit për vitin 2026 mund ta gjeni në linkun e mëposhtëm: https://tka.hu/docs/palyazatok/1_list_of_summer_courses_2026.pdf

- Shkolla Verore e Debrecenit – Gjuha dhe Kultura Hungareze, 2 gusht- 15 gusht.
- Shkolla Verore e Debrecenit – Gjuha dhe Kultura Hungareze, 19 korrik- 15 gusht.
- Universiteti Katolik Eszterházy Károly – Kultura e Verës dhe Gastronomia e Verës, 29 qershor- 10 korrik.
- Universiteti Katolik Eszterházy Károly – Universiteti Veror i Gjuhës dhe Kulturës Hungareze, 29 qershor- 10 korrik.
- Akademia Hungareze e Diplomacisë (Kft.) – Hungarisht për të Huaj, 13 korrik- 8 gusht.
- Universiteti i Vallëzimit Hungarez – Kurs Ndërkombëtar Veror Intensiv i Baletit, 2 gusht-16 gusht.
- Universiteti i Nyíregyháza-s – Gjuha dhe Kultura Hungareze, 6 korrik-19 korrik.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

- Universiteti i Pécs-it – Studime Evropiane, 5 korrik - 18 korrik.
- Universiteti i Pécs-it, Fakulteti i Shkencave Humane dhe Sociale – Gjuha dhe Kultura Hungareze, 19 korrik- 2 gusht.
- Universiteti i Szeged-it – Vallëzimi dhe Muzika Tradicionale në Evropën Qendrore dhe Lindore, 21 qershor- 4 korrik.
- Universiteti i Szeged-it – Hungarisht për të Huaj, 19 korrik-15 gusht.

DREJTORIA E INTEGRIMIT, MARRËVESHJEVE DHE PROJEKTEVE